

DEPARTAMENTI



I EMISIONIT

BANKA E SHQIPËRISË

Në nenin 161 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është përcaktuar se Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive të nxjerrjes dhe të qarkullimit të monedhës shqiptare. Këtë detyrë Banka e realizon nëpërmjet veprimtarisë së Departamentit të Emisionit.

Njësia monetare në Republikën e Shqipërisë është "Leku".

Në mbështetje të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", kartëmonedhat dhe monedhat që emeton Banka e Shqipërisë, kanë kurs ligjor dhe pranohen për të gjitha pagesat e detyrimeve publike e private pa kufizim, me vlerën e tyre nominale.

Format, masat, pesha, modeli dhe karakteristikat e tjera të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare, të cilat kanë kurs ligjor si dhe të monedhave e kartëmonedhave që do të shtypen për qëllime numizmatike, përcaktohen nga Banka e Shqipërisë.

Përsa më sipër, Banka e Shqipërisë, në përputhje me hartimin, me miratimin dhe me zbatimin në mënyrë të pavaruar të politikës monetare të Republikës së Shqipërisë si dhe të programit monetar të miratuar, përcakton sasinë dhe vendos për procedurat e shtypjes së kartëmonedhës dhe të monedhës kombëtare, që ka kurs ligjor dhe të atyre që do të shtypen për qëllime numizmatike. Sasia e shtypjes së kartëmonedhave dhe monedhave metalike me kurs ligjor përcaktohet në bazë të strategjive afatmesme dhe planeve të emetimit, të cilat kanë si qëllim kryesor plotësimin e kërkesave të ekonomisë për para, në vlerë dhe në strukturë të përshtatshme. Për furnizimin e ekonomisë me para, Departamenti përdor strukturat përkatëse në qendër dhe në rrethe.

Në të njëjtën kohë, departamenti realizon grumbullimin e tepricave të *cash-it* dhe të kartëmonedhave e monedhave të dëmtuara nga qarkullimi, me qëllim zëvendësimin e këtyre të fundit, me të reja.

Departamenti realizon edhe përpunimin, shkëmbimin dhe kompensimin e monedhave shqiptare, procese të cilat kryhen në bazë të kriterëve të përcaktuara.

Departamenti realizon hedhjen në qarkullim të emetimeve të reja duke bërë publik, të paktën një muaj më parë, njoftimin zyrtar të Bankës së Shqipërisë. Njoftimi realizon një detyrim për të vënë në dijeni, publikun shqiptar.

Me njoftim zyrtar, departamenti realizon edhe vendimet e Këshillit Mbikëqyrës për mbledhjen dhe për tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave dhe të monedhave të emetuara më parë, kundrejt pageses së vlerës fillestare të emetimit. Në shkëmbim të tyre emetohen kartëmonedha dhe monedha metalike të tjera. Periudha për ndërrime është jo më pak se një vit nga shpallja e njoftimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë në Fletoren Zyrtare. Në përfundim të afatit, kartëmonedhat dhe monedhat metalike të shpallura për t'u mbledhur e tërhequr, nuk kanë më kurs ligjor dhe nuk pranohen për pagesa.

Përveç emetimit të kartëmonedhave dhe monedhave metalike me kurs ligjor, Banka e Shqipërisë emeton edhe kartëmonedha dhe monedha metalike për qëllime numizmatike.

Për kartëmonedhat dhe monedhat metalike me kurs ligjor dhe për ato për qëllime numizmatike, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka miratuar akte nënligjore, në lidhje me sasitë dhe me procedurat për eksport- importet e tyre.

Në mënyrë të vazhdueshme gjatë dhjetë viteve të fundit janë emetuar seri të kartëmonedhave dhe të monedhave metalike me kurs ligjor dhe për qëllime numizmatike.

Në vitin 1992 janë emetuar prerjet 200, 500 dhe 1000 lekë seri e parë e kartëmonedhave që u emetuan nga Banka e Shqipërisë. Në vitin 1993 u shtyp kartëmonedha me prerje 100 lekë. Të dyja këto emetime u rishtypën në vitin 1994. Në vitin 1995 u rishtyp kartëmonedha me prerje 1000 lekë e vitit 1994 me elemente sigurie të përmirësuara. **Në vitin 1996** janë emetuar seri kartëmonedhash me prerje 100, 200, 500 dhe 1000 lekë si riprintim i serisë së kartëmonedhave të vitit 1994 dhe ajo 500 lekë si riprintim i të njëjtës prerje të vitit 1991. Në këtë vit është realizuar një emision i ri i kartëmonedhave me prerje 100, 200, 500, 1000 dhe 5000 lekë (**prerja 5000 lekë u emetua për herë të parë**). Gjithashtu, u emetua seria e parë e **monedhave metalike** me prerje 1, 10, 20, dhe 50 lekë nga Banka e Shqipërisë, ndërsa **prerja 5 lekë mban vitin 1995**. Në **vitin 2000** u emetua seria e monedhave me prerjet 5, 10, 20, 50 dhe **për herë të parë prerja 100 lekë**. Në këtë periudhë, prerja 100 lekë paraqitet e dubluar në formë kartëmonedhe dhe monedhe metalike.

Gjatë gjithë kësaj periudhe, me shtypjen dhe me emetimin e kartëmonedhave dhe të monedhave të reja, me vendime të Bankës së Shqipërisë, janë mbledhur dhe tërhequr në mënyrë graduale nga qarkullimi kartëmonedha dhe monedha metalike, emetime të viteve 1976-1991.

Në vitin 2001 u shtypën: seri monedhash me tematike "Integrimi i Shqipërisë në Europë" dhe "500 – vjetori i Statujës së Davidit, Mikelanxhelos".

Për periudhën afatmesme, Departamenti i Emisionit ka studiuar dhe ka përcaktuar strukturën e përshtatshme dhe të pranueshme nga publiku për monedhën në qarkullim, në të cilën rritet pesha e prerjes 5000 lekë. Kjo prerje u hodh në qarkullim në janar të vitit 1999, duke arritur që në datën 30.06.2002, pesha e saj në strukturën në vlerë të monedhës në qarkullim të përfaqësojë 23,33 për qind. Struktura aktuale e monedhës në qarkullim vlerësohet si një strukturë e pranueshme dhe do të vazhdojë të ruhet. Objektivi strategjik i Departamentit është heqja nga qarkullimi e kartëmonedhave të emetuara para vitit 1996 dhe lënia në qarkullim vetëm e kartëmonedhës të së njëjtës pamje (ato të vitit 1996 dhe rishtypjet e tyre të mëvonshme).

Në trevjeçarën e ardhshëm do të fuqizohet teknologjia e përpunimit të monedhës, e kontrollit të saj, informatizimi i procesit të administrimit të parasë si dhe veprimtaria për edukimin më të gjerë të publikut në fushën e monedhës.

Prezantimi fizik i euros në 1 janar të vitit 2002 kërkoi vëmendje dhe angazhim serioz nga Departamenti gjatë gjithë vitit 2001. Ky proces, përveç të tjerave, realizoi njoftimin dhe familjarizimin e publikut me monedhën e re si dhe vënien në gatishmëri të kapaciteteve për mbajtjen e rezervave të mjaftueshme në euro dhe për shpërndarjen në kohë të tyre.